



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 380/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga koalicioni LDK-AKR, paraqitur kundër Vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Blerim Grainca kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 30.06.2017 në ora 12:05, ka pranuar një ankesë nga Blerim Grainca kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR, në të thekson se në komunën e Shtimes në bazë të raportit të LDK-së i ka 430 vota. Nga shumica e vendvotimeve në komunën e Shtimes rezulton se ka marr 319 vota (pa numërimin e disa vendvotimeve). Në vazhdim thekson se nga rezultatet e KQZ-së (QNR) dalin 246 vota, kështu që gjatë numërimit në QNR numri 319 do të duhej të rritet e jo të zvogëlohet, pasi që se asnjë qendër votimi nuk është anuluar. Si dëshmi ka bashkangjitur formularët e vendvotimit të marra në KKZ.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës me asnjë provë apo dëshmi nuk ka argumentuar se në cilin vendvotim i janë bërë parregullsitë siç pretendon, Parashtrimet në ankesë nuk paraqet bazë ligjore për parregullsi dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favore të ankuesit .

Paneli vlerëso se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotëson standardet ligjore si dhe kërkesat e nenit 117 të LZP-së.

PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.380/2017 më datën 01.07.2017.



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.